



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
Sekretaria

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.11.2023

**MBLEDHJA Nr. 57,**  
**Datë 08.11.2023, ora 12:00**  
**e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Mërkurë, datë 08.11.2023, ora 12:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 57 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbal-ve të mbledhjeve të bordit të ERE-s më datë 23.10.2023 dhe datë 30.10.2023
2. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Tetor 2023 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV
3. Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e mosmarveshjes ndërmjet FTL sh.a. dhe shoqërive: (i) TREN SUN SYSTEM sh.p.k., (ii) SUN BEAT SYSTEM sh.p.k., (iii) NTSP sh.p.k., (iv) KORCA PHOTOVOLTAIC PARK sh.p.k.
4. Mbi pajisjen me Certifikatë të Garancisë së Origjinës për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme
5. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr.217, datë 20.12.2019, “Mbi licencimin e shoqërisë “ELVA 2001” sha në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “MIVAS”, me kapacitet të instaluar 1940 Kw”

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**